



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 711/1 Prot.

Tiranë, më 13.07.2023

**V E N D I M**

**Nr. 65, datë 13.07.2023**

***PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR PËR MBLEDHJEN E  
INFORMACIONIT LIDHUR ME EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE TË  
FORMËS SË PRERË NGA INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar nenit 142/3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të thesarit”; Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015, të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, “Zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit,

**V E N D O S A:**

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar pranë institucioneve të administratës shtetërore, ku përfshihet Kryeministria, të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë, për mbledhjen e informacionit në lidhje me gjendjen aktuale të zbatimit të nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, të cilat rregullojnë institutin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues.

2. Ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces, me përbërje si më poshtë:

<b>Arbana Basha</b>	Drejtor i Përgjithshëm i Inspektimit dhe Mbikëqyrjes (Drejtues metodologjik i grupit)
<b>Irma Vani</b>	Drejtor i Çështjeve Juridike Integritit dhe Studimeve
<b>Helga Peti</b>	Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Juridike
<b>Armelda Petrela</b>	Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Juridike

Për realizimin e kësaj detyre, Grupi i Punës, brenda **10 ditëve** nga dalja e këtij vendimi, të kërkojë nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore të përfshira në proces, informacionin e nevojshëm, të detajuar në programin e mbikëqyrjes, i cili ka lidhje me procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga ana e institucioneve të administratës shtetërore gjatë vitit 2023, për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues, si dhe të mbajë komunikim të vazhdueshëm me këto subjekte, me qëllim mbarëvajtjen e këtij procesi.

3. Për dërgimin e informacionit nga institucionet e administratës shtetërore të lihet një afat prej **10** ditësh, duke nisur nga momenti i marrjes dijeni për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar.
4. Pas mbledhjes së informacionit paraprak grupi i punës do paraqitet në institucion për të verifikuar dokumentacionin që materializon procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.
5. Ky proces do të përmbyllet me një Raport Vlerësimi të hartuar nga Grupi i Punës, ku do të evidentohet situata për çdo institucion dhe do të propozohen rrugët dhe mjetet për rregullimin e paligjshmërisë. Ky raport do të miratohet nga Komisioneri dhe do të jetë një prej dokumenteve mbi të cilin do të mbështetet edhe planifikimi i subjekteve që do të mbikëqyren gjatë vitit 2024.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Çështjeve Juridike që të zbatojnë këtë vendim, duke angazhuar në mbikëqyrje anëtarët e grupit të punës, të përcaktuar në pikën 2 të tij.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që nëpërmjet specialistit të arkiv-protokollit, t’ia njoftojë këtë vendim të gjithë anëtarëve të grupit të punës, si

edhe të ofrojë asistencën e nevojshme logjistike për të mundësuar realizimin e këtij procesi.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**